



5

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

PROJEKTVENDIM

NR. __, DATË __ 2026

PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ 473320.05 (KATËRQIND E SHTATËDHJETË E TRE MIJË E TREQIND E NJËZETË PIKË ZERO PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET", PËR RRUGËN "ÇEL ISLAMI"

Mbështetur në Nenin 41 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", i ndryshuar, Ligjin nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore"; Urdhrin e kryetarit të bashkisë nr. 66, datë 25.02.2025, "Për ngritjen e grupit të punës, për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik, me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në qytet", për rrugën "Çel Islami", sipas relacionit të përgatitur nga Drejtoria Ligjore. kryetari i bashkisë i propozon këshillit bashkiak.

PËR TË VENDOSUR:

1. Miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, për pasuritë pronë private, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në qytet", për rrugën "Çel Islami", sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimit.
2. Fondi i shpronësimit me vlerë (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, të parashikohet në buxhetin e vitit 2026. Lëvrimi i fondit do të kryhet pasi të jetë botuar VKM-ja për shpronësim.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ligjore.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i Prefektit të Qarkut Durrës.

DREJTORIA LIGJORE

Almeida Rroshi

KRYETAR

Emiriana Sako



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DURRËS

RELACION

**PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ
PËR MIRATIMIN NË PARIM TË VLERËS FINANCIARE TË SHPRONËSIMIT PREJ
473320.05 (KATËRQIND E SHTATËDHJETË E TRE MIJË E TREQIND E NJËZETË
PIKË ZERO PESË) LEKË, PËR PASURITË PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA
INVESTIMI PUBLIK ME OBJEKT: "RIKONSTRUKSION I RRUGËVE NË QYTET",
PËR RRUGËN "ÇEL ISLAMI"**

PARA KËSHILLIT BASHKIAK KËTU

Të nderuar këshilltarë!

Projekt vendimi që po ju paraqesim për shqyrtim e miratim, ka për qëllim miratimin në parim të vlerës financiare të shpronësimit prej (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, për pasuritë pronë private, sipas tabelës së hartuar nga grupi i punës, i ngarkuar për kryerjen e vlerësimit paraprak, dhe është pjesë e këtij vendimi, që preken nga investimi publik me objekt: "Rikonstruksion i Rrugëve në Qytet – Rruga "Çel Islami".

1. Qëllimi dhe interesi publik

Projekti "Rikonstruksion i rrugëve në qytet – Rruga "Çel Islami" synon përmirësimin e infrastrukturës rrugore urbane dhe garantimin e aksesit normal dhe të sigurt për banorët e zonës. Rruga "Çel Islami" shërben si e vetmja lidhje rrugore për 10 banesa, të cilat aktualisht nuk kanë akses rrugor funksional.

2. Gjendja aktuale e rrugës

Në gjendjen aktuale, rruga "Çel Islami":

- ka gjerësi minimale, e kalueshme vetëm për një karrocë dore;
- jashtë çdo standardi minimal teknik;
- nuk lejon qarkullimin e automjeteve, përfshirë ambulancën, zjarrfikësen apo mjetet e shërbimeve publike; është pa ndriçim publik;
- është pa sistem kanalizimesh dhe kullimi;
- paraqet rrezik real për sigurinë e banorëve, veçanërisht për fëmijët, të moshuarit dhe në raste emergjente.

Këto kushte e bëjnë ndërhyrjen jo vetëm të nevojshme, por të domosdoshme dhe urgjente, në funksion të interesit publik.

3. Përgjegjësia ligjore e Bashkisë

Detyrimi për realizimin e këtij projekti buron drejtpërdrejt nga ligji nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar. Në mënyrë të veçantë, neni 23 i këtij ligji përcakton se, në fushën e infrastrukturës, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e tyre për: "ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, trotuareve dhe shesheve publike vendore".

Duke e konsideruar si funksion të vetin, nga ana e bashkisë është projektuar, financuar dhe lidhur kontratë pune me të tretët për investimin me objekt: "Rikonstrukcion i Rrugëve në Qytet – Rruga "Çel Islami".

Në funksion të këtij projekti, Bashkia Durrës, duke respektuar të drejtën kushtetuese dhe ligjore të pronës private dhe detyrimin për kompensimin e saj të drejtë, ka kryer procedurat për identifikimin dhe vlerësimin e pasurive që preken nga investimi. Grupi i punës i ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë ka zhvilluar procesin e vlerësimit paraprak të pasurive, duke u bazuar në këto akte dhe burime:

a) *Projektin e miratuar*

b) *gjurmen e shpronësimit*

c) *vlerësimin e pasurisë që do të shpronësohet*

Nisur nga fakti se projekti prek vetëm pasuri të llojit truall, për vlerësimin e zërit kadastral tokë truall, bazuar në ligjin e posaçëm për shpronësim dhe aktet nënligjore dalë në bazë e për zbatim të ligjit, komisioni i vlerësimit është bazuar në VKM –në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Ky akt normativ përcakton çmimet zyrtare të tokës për zona të ndryshme dhe shërben si bazë për përllogaritjen e shpërblimit në rast shpronësimi. Vlera e tokës truall, e prekur nga projektit, sipas VKM-së nr. 89/2016, ZK 8512 është 19155 lekë/m².

4. *Nevoja për shpronësim*

Për realizimin e projektit dhe zgjerimin e gjurmës së rrugës, lind nevoja për shpronësimin e një sipërfaqeje trualli, në pronësi private. Konkretisht:

a) *Sipërfaqja që shpronësohet: 24,71m².*

b) *Lloji i pasurisë: Truall.*

c) *Vendndodhja: pranë "Viles Zogu", ish-repart ushtarak i artilerisë bregdetare.*

c) *Zona Kadastrale: ZK 8512.*

Pa realizimin e këtij shpronësimi, projekti nuk mund të zbatohet dhe problematika e aksesit rrugor për 10 familjet mbetet e pazgjidhur, banorët mbeten të izoluar, cenohet siguria dhe e drejta për shërbime publike bazë.

5. *Vlera e shpronësimit*

Vlera e shpronësimit për sipërfaqen tokë truall prej 24,71m², që preket nga projekti është 473320.05 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë. Kjo vlerë është përcaktuar: në përputhje me ligjin nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen e përkohshme të pronës private për interes publik", i ndryshuar; VKM –në nr. 138, datë 23.03.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe llogaritjes së dëmshpërblimeve në rast shpronësimi", i ndryshuar; VKM –në nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, duke respektuar parimin e shpërblimit të drejtë dhe të plotë për pronaret e prekur.

Në këtë vlerë nuk përfshihen pasuritë me gjendje juridike shtet, mbasi vlera e tyre është 0 (zero). Evidentimi i pasurive me gjendje juridike "shtet" ka për qëllim vetëm rakordimin me institucionet shtetërore apo publike, që i kanë në pronësi apo administrim këto pasuri, me qëllimin për të kryer veprimet në kontabilitet. Pra, pasuritë me gjendje juridike "shtet" nuk shpronësohen, por për rastin kur kërkuesi është institucion shtetëror apo publik, këto pasuri pas miratimit nga Këshilli i Ministrave, kalon në favor të investitorit pa kundërshtpërbllim, dhe vlera e këtyre pasurive është 0 (zero).

6. Interesi publik dhe impakti social

Realizimi i këtij projekti:

- *garanton akses të denjë dhe të sigurt rrugor për 10 familje;*
 - *mundëson hyrjen e shërbimeve emergjente në çdo kohë;*
 - *përmirëson ndjeshëm kushtet e jetesës dhe sigurinë publike;*
 - *kontribuon në zhvillimin urban dhe integrimin e zonës me rrjetin rrugor ekzistues;*
 - *eliminon një problematikë të trashëguar ndër vite, që ka prekur drejtpërdrejt jetën e banorëve.*
- Ky projekt nuk është thjesht një ndërhyrje infrastrukturore, por një zgjidhje sociale dhe humane, që i rikthen banorëve një të drejtë bazë: të drejtën për lëvizje dhe akses.

7. Përfundim

Në përfundim, miratimi i vlerës së shpronësimit prej 473320.05 (katërqind e shtatëdhjetë e tre mijë e treqind e njëzetë pikë zero pesë) lekë, për sipërfaqen 24.71 m² truall, në ZK 8512, është:

- *ligjërishit i mbështetur;*
- *ekonomikisht i arsyeshëm;*
- *shoqërisht i domosdoshëm;*
- *dhe në interes të drejtpërdrejtë publik.*

Për këto arsye, i propozohet Këshillit Bashkiak miratimi i vlerës së shpronësimit, si kusht i domosdoshëm për realizimin e projektit "Rikonstruksion i rrugëve në qytet – Rruga "Çel Islami". Pas marrjes së Vendimit nga ana juaj, materiali ligjor e teknik, që bën fjalë për shpronësimin, si dhe Vendimi i pritshëm nga ana juaj, do t'i përcillet Agjencisë Shtetërore të Shpronësimit, kjo sipas përcaktimit të VKM-së nr. 395, datë 13.05.2020, "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin".

Pjesë e këtij relacioni janë dhe aktet e mëposhtme:

1. Urdhri i kryetarit të Bashkisë nr.66, datë 25.02.2025, "Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga investimi publik, me objekt: "Rikonstruksion i rrugëve në qytet, për rrugën "Çel Islami".
2. Projekti, i miratuar me leje nr.878-24, datë 12.07.2024.
3. Përgjigjet e ardhura nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Durrës-Kavajë-Krujë në rrugë elektronike me email zyrtar, nënshkruar elektronikisht datë 16.01.2026, ku i përgjigjet kërkesës sonë për kartelë pasurie dhe HTR që i përkasin 9 pasurive që preken nga projekti.
4. Raporti i Grupit të Punës, drejtuarit kryetarit të bashkisë, që bën fjalë për zbatimin e urdhrin nr. 66, datë 25.02.2025.

5. Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë", ku ndër të tjera është përcaktuar vlera e tokës truall, që preket nga projekti, sipas Zonave Kadastrale ku shtrihet projekti i bashkisë.
6. Planvendosjet e pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga investimi.
7. Tabela në Exel, ku pasqyrohet lista paraprake e pasurive që preken dhe që shpronësohen për interes publik nga projekti, i nëshkruar nga grupi i punës sipas formatit tip të ASHSH-së.

DREJTORIA LIGJORE

Alneida Rroshi



**SEKTORI I PRONAVE PUBLIKE, MENAXHIMIT TE ASETETEVE
DHE PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT**

Jetmir Pupla



Konc. Gr. i punës i ngritur me urdhër nr. 66, datë 25.02.2025

Elsa Kalesha

Enli Kaçuli

Aleks Prenga

